

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-125/12

**Prishtinë,
10 dhjetor 2013**

Në çështjen juridike të:

S.M.

i përfaqësuar nga K. M.

Paraqitësi i kërkesës- Pala përgjegjëse në ankesë

kundër

S. Sh.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Ertezi dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur në ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/119/2011 i datës 7 shtator 2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13616), pas shqyrtimit të mbajtur me 10 dhjetor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

Anulohet vendimi i KPCC/D/A/119/2011, i datës 7 shtator 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13616, si dhe e njejta kthehet në KKPK për rishqyrtim.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me 4 tetor 2006, K. M. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke pretenduar se S. M. është pronar legjitim i ngastrës kadastrale nr. 1799 që ndodhet në vendin e quajtur “Mushtist”, komuna e Suharekës. Duke pretenduar se humbja e posedimit ka ndodhur për shkak të konfliktit të armatosur, ajo kërkoi ri-posedimin e pronës së kërkuar. Ajo pretendoi se S. M. e ka trashëguar pronën nga i ndjeri babai i tij T.M.. Ajo tutje pretendon se familja M. e ka shfrytëzuar këtë pronë deri në mes të qershorit 1999 kur janë detyruar të largohen për shkaqe sigurie.

2. Për ta mbështetur kërkesën, ajo paraqiti kopjen e fletës poseduese nr. 674 të lëshuar nga Republika e Serbisë, Zyra e Republikës për Gjeodezi, Shërbimi Kadastral i Pronave të Paluajtshme në Suharekë të lëshuar me 27 janar 2003. Fleta poseduese konstaton se ngastra nr. 1799 është e regjistruar në emër të T.S. M. Ajo ofroi certifikatën e martesës të datës 28.11.1993 për martesën e saj me S. M.; autorizimin e dhënë nga S.M. i datës 17 shtator 2007 (me nr. të letërnjoftimit 253205); Çertifikatën e vdekjes së S. M. ku figuron data e vdekjes me 20 dhjetor 2002; kopja e kontratës për ndarje të pronës në mes të D. T.M., S. T. , S.T. M. dhe C. T. M., me datë 13 dhjetor 2002, që tregon se mes tyre, M. T. S. ka të drejtën për ngastrën nr. 1799.

3. Me 21 tetor 2008, K.M. paraqiti një shkresë ku thuhet se ajo ka pretenduar që i ndjeri vjehri i saj S. T. është pronar i pronës. Ajo po ashtu përmendi se ka siguruar dokumente që tregojnë se T. është vjehri i saj, por ajo nuk ka mundur ta sigurojë certifikatën e vdekjes së të ndjerit gjyshit M.T. M..

4. Fleta poseduese dhe autorizimi, të vërtetuara në Gjykatën Komunale nr. 5 të Beogradit, me numër VR. Nr. 27620/07, i dhënë nga S. M. tek K. M., janë verifikuar nga AKP-ja.

5. AKP-ja fillimisht bëri një njoftim jo korrekt të pronës. Prandaj, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka vulosur vendimin e vërtetuar të mëparshëm lidhur me kërkesën nr. KPA13616, KPCC/D/A/25/2008 i datës 23 tetor 2008, i marr në bazë të njoftimit të gabueshëm si jo i ligjshëm.

6. Një njoftim tjetër i pronës është bërë nga AKP-ja përmes metodës së njoftimit me anë të publikimit në gazetë, pa e vendosur shenjën në ngastrën e saktë kadastrale të kërkuar. Kjo është konfirmuar me anë të njoftimit dhe raportit të konfirmimit i datës 30 gusht 2010.

7. Asnjë njoftim për pjesëmarrje në procedurë nuk është paraqitur.

8. Me 7 shtator 2011, KKPK-ja me vendimin grupor të dytë e miratoi kërkesën. Në vendimin e vërtetuar të datës 25 nëntor 2011, është konfirmuar se paraqitësja e kërkesës K. M. ka vërtetuar se S. M. është pronar i pronës së kërkuar dhe K. M. ka të drejtë ta posedoj pronën në fjalë. KKPK-ja po ashtu urdhëroi lirim e pronës nga uzurpuesi, nëse ekziston.

9. Vendimi i është dërguar K.M. me 2 prill 2012 ndërsa S. Sh. me 23 gusht 2012 me një shënim ku urdhërohet ta lirojë pronën brenda 30 ditëve.

10. Me 6 shtator 2012, S. Sh. paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

11. Ankesa e S. Sh. i është dërguar K. M. me 11 tetor 2012. Asnjë përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

12. Me 13 mars 2013, gjyqtari i Kolegjit të Apelit të AKP-së së Gjykatës Supreme ka lëshuar urdhër për paraqitësin e kërkesës 'S. M.' i përfaqësuar nga 'K. .' kështu duke iu mundësuar atyre të përgjigjen në ankesë, në veçanti ndaj pretendimeve të palës ankuese, i cili pohoj se ngastra kontestuese është blerë nga babai i palës përgjegjëse në kërkesë dhe se familja e tij ka qenë në posedim të ngastrës qysh nga vitet 1981-1982. Në të njëjtën mënyrë, paraqitësi i kërkesës është udhëzuar ta sigurojë autorizimin e K.M. të dhënë nga Svetomir Milosević dhe një kopje të letërnjoftimit të tij dhe certifikatën e vdekjes së S. M. për të vërtetuar pozitën e tij si kryefamiljar i familjes së pronarit. Është shënuar po ashtu se gjykata sqaron- nëse dorëzohet autorizimi - se pala në procedurë nuk është K.M. por bashkëshorti i saj S. M..

13. Me 17 tetor 2013, AKP-ja ka informuar Kolegjin e Apelit të AKP-së se urdhri i është dërguar K. M. me 12 korrik 2013; megjithatë, ata nuk kanë pranuar asnjë përgjigje.

Argumentet e palëve

14. Kërkesa është parashtruar nga K.M., e cila më vonë ka sqaruar se bartësi i së drejtës së pronës është vjehrrri i saj S. T.M.. Ajo deklaroi se ajo përfaqëson bashkëshortin e saj S.M.. Ajo po ashtu pretendoi se familja Milosević e ka shfrytëzuar pronën deri në qershor 1999 dhe e ka humbur posedimin për faktin se janë larguar nga Kosova për shkaqe sigurie. Ajo përmendi se prona është uzurpuar nga fqinjë të familjes M..

15. Pala ankuese S. Sh. i kundërshtoi pretendimet se prona kontestuese është shfrytëzuar nga familja Milosević deri në vitin 1999. Ai pretendoi se trashëgimtarët e pronarit ia kanë shitur ngastrën nr. 1799 Gj. Sh., babait të tij, në vitet 1981-1982 me një kontratë interne. Ai pretendonte se kontrata e shitblerjes është djegur gjatë konfliktit të armatosur. Ai në vijim ka pretenduar se prona e kërkuar ishte shfrytëzuar nga familja e tij që nga vitet 1981-1982. Ai i dha emrat e dëshmitarëve M. S. Sh. dhe I. A. Sh. të cilët mund t'i vërtetojnë pretendimet e tij.

16. Në ankesën e tij, ai tutje ka argumentuar se KKKPK-ja, as në dispozitiv të vendimit e as në arsyetimin e dhënë nuk e ka sqaruar statusin e paraqitësit të kërkesës lidhur me bartësin e së drejtës së pronës. Ai pohoi se ajo nuk kishte ofruar prova për të dëshmuar lidhjen e saj me bartësin e së drejtës së pronës dhe nuk mund të konsiderohet si person me të drejtë për të kërkuar pronën. Ai pohon se kjo është një shkelje e rëndë e procedurës.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

17. Pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurë në KKKPK-së. Ai është privuar nga e drejta e pjesëmarrjes në procedurë në shkallë të parë për shkak të njoftimit të gabueshëm të pronës. Sipas juridiksionit të përcaktuar qartë për Kolegjin e Apelit të AKP-së, njoftimi përmes Gazetës Njoftuese të AKP-së dhe Buletinit të UNHCR, nuk është “përpjekje e arsyeshme” njoftimi i kërkesës siç parashihet me Nenin 10.1 të UNMIK/REG/2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (në vijim si Ligji 03/L-079). Gjykata Supreme nuk ka mundur të vërtetojë se pala ankuese ishte informuar siç duhet rreth kërkesës (shih GSK-KPA-9/2010, 28/12, 103/2012, 105/2012, 130/2012 etj.) Ai parashtrroi ankesë brenda 30 ditëve pasi që ka pranuar vendimin përmes së cilit ai është njoftuar edhe për kërkesën. E drejta e tij për ankesë nuk mund të mohohet. Ankesa, e parashtruar brenda afatit të dhënë me Ligjin 03/L-079, është e pranueshme.

Meritat e ankesës

18. Ankesa është e bazuar. Vendimi i KKKPK-së duhet të priset dhe lënda duhet të kthehet prapa në rishqyrtim pasi që Gjykata Supreme vërejtë zbatimin e gabueshëm të ligjit material dhe të procedurës.

19. Në përgjithësi, pala ka të drejtë të dëgjohet jo vetëm nga një instancë por nga së paku dy instanca. Nëse pala privohet nga kjo e drejtë për shkak të ndonjë gabimi thelbësor të shkallës së parë, kjo duhet të konsiderohet si shkelje materiale dhe procedurale. Gjykata Supreme në shumë raste ku kërkesat u trajtuan si jokontestuese dhe ku pala ankuese nuk ishte në dijeni rreth kërkesës, gjeti se ishte e nevojshme të anulohet

vendimi i KKPK-së dhe lënda të kthehet në rishqyrtimi. Gjykata i referohet lëndës me nr. GSK-KPA-A-14-2012. Kjo procedurë ia mundëson palës ankuese të marr pjesë në procedurë në shkallë të parë, dhe e lejon palën humbëse ta kundërshtoj një vendim që është marrë pas shqyrtimit të plotë të të gjitha aspekteve relevante të lëndës.

20. Në rastin në fjalë, pala ankuese është privuar nga mundësia e paraqitjes së argumenteve për bazën e kërkesës si dhe është kontestuar juridiksioni i KKPK-së për shkak të njoftimit jo të duhur të pronës së kërkuar siç është theksuar më lartë. Gjë që kërkon gjykim të plotë të kërkesës në shkallë të parë.

21. Për më tepër, sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedimin e pronës nëse parashtruesi i kërkesës dëshmon pronësinë apo të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën e paluajtshme private dhe nëse ai apo ajo tani nuk është në gjendje ta ushtrojë këtë të drejtë për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Të dyja kushtet duhet të përmbushen.

22. Pala ankuese, së pari, ka kundërshtuar pohimet rreth posedimit të pronës së kërkuar nga familja Milosević deri në vitin 1999. Në ankesë, ai donte ta vërtetonte posedimin e pronës që nga viti 1982 përmes deklaratave të dëshmitarëve. Këta dëshmitarë nuk kanë mundur të dëgjohen në shkallën parë pasi që emrat e tyre janë siguruar vetëm në ankesë. Prandaj, juridiksioni i KKPK-së është në rrezik, nëse pala ankuese mund ta dëshmojë se nuk ishte familja e paraqitësit të kërkesës por pala ankuese që e kishte në posedim tokën që nga viti 1982 siç pretendon ai, që nënkupton se humbja e posedimit nuk është për shkak të rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur por një kontest tjetër në mes palëve. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme vëren se përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës nuk u përgjigj në pretendimet e palës ankuese, as kur ankesa i është dërguar asaj, e as pas vendimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Kjo është një tjetër rrethanë se ajo nuk e konteston pretendimin e palës ankuese lidhur me posedimin e pronës së kërkuar gjatë dhe madje shumë kohë para konfliktit pavarësisht ligjshmërisë së saj.

23. Së dyti, KKPK-ja ia miratoi kërkesën Katarina Milosevićit. Në formulimin e vendimit të vërtetuar, ajo është njohur si pronare e pronës së kërkuar. Në vijim thuhet se ajo ka të drejtën e posedimit të pronës në fjalë. KKPK-ja ka përjashtuar që K. M. nuk ishte bartëse e së drejtës së pronës e as paraqitësi i kërkesës si kryefamiljar i familjes së bartësit të së drejtës pronësore. S. T. M. është i regjistruar si pronar në fletën poseduese nr. 674, po ashtu është identifikuar që është vjehri i saj. Siç përmendet në urdhrin e Gjykatës Supreme të datës 13 mars 2013, ajo nuk e kërkoi pronën si kryefamiljare; mirëpo, si përfaqësuese e bashkëshortit të saj S. M.. KKPK-ja gabimisht miratoi kërkesën në favor të saj.

24. Së treti, argumentet e palës ankuese janë të sakta që ajo nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar përkatësinë familjare me pronarin e regjistruar. Ajo nuk paraqiti ndonjë provë për të vërtetuar të drejtën e saj mbi pronën e kërkuar e as të drejtën e S. M., ashtu siç ka bërë KKPK-ja në vendimin e saj. Ajo nuk ofron as edhe vendimin e trashëgimisë ku njihet e drejta e trashëgimisë së paraqitësit të kërkesës S. M. ndaj pronës së të ndjerit S.T. M.. Ende mungon lidhja në mes të atyre dyve.

25. Për më tepër, pavarësisht marrjes së udhëzimit të qartë të Gjykatës Supreme gjatë procedurës ankimore, përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës nuk ka ofruar asnjë provë për të treguar se S. M. është një nga trashëgimtarët e pronarit të regjistruar S.T. M..

25. Vendimi i KKPK-së duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në KKPK. Gjykata Supreme gjen të nevojshme që AKP-ja dhe KKPK-ja të qartësojë nëse kërkesa ka të bëjë me rrethanat që rezultojnë nga konflikti i armatosur ose për shkak të gjendjes faktike, jo të lidhura ose që nuk rezultojnë nga konflikti. Në rast se Komisioni vjen në përfundim se ka juridiksion ndaj kësaj kërkesë sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, dhe më pas argumentet e palëve për meritat e kërkesës do të shqyrtohen nga KKPK-ja. Prova për të vërtetuar titullin e parashtruesit të kërkesës duhet të kërkohej dhe verifikohet nga AKP-ja dhe të ekzaminohet nga KKPK-ja. Një vendim i ri duhet të merret nga shkalla e parë. Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

26. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it